

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK



Tema:

Të drejtat fqinjësore si kufizuese të pronësisë – vështrim krahasues

Mentori/ja:

Prof.Ass. Dr. Qerkin BERISHA

Kandidatja:

Sara FAZLIU

Abstrakt

Ky punim synon të prezantojë të drejtat fqinjësore si rregullator për kufizimin e së drejtës pronësore.

Punimi është i ndarë në gjithsej 8 kapituj. *Kapitulli i parë* parasheh Metodologjinë e punimit, i cili shpjegon metodat kërkimore dhe pyetjet kërkimore që ndihmojnë në zhvillimin e hipotezës.

Kapitulli i dytë parasheh shtjellimin e temës si përmbajtje të shkurtë të punimit me disa shpejgime të shkurtëra për secilin kapitull.

Kapitulli i tretë qëndron për vështrimin teorik mbi pronësinë dhe kuptimin e saj, ku shpjegohet pronësia në kuptim të ngushtë, kuptimi i të drejtave absolute dhe parimet e të Drejtës Sendore (Parimi i absolutitetit të të drejtave sendore, Parimi i numrit të kufizuar të të drejtave sendore (numërimi taksativ), Parimi i publicitetit të të drejtave sendore dhe Parimi i specialitetit (specifitetit) të të drejtave sendore) dhe shpjegohet secila veç e veç.

Kapitulli i katërt parasheh kuptimin dhe përmbajtjen e të drejtave fqinjësore si kufizuese të pronësisë, ku të drejtat fqinjësore analizohen duke u bazuar në legjislacion pozitiv dhe krahasues, si dhe mbi bazën e shqyrtimeve teorike. Këto çështje, trajtohen në mënyrë të detajuar, duke përfshirë këtu trajtimin sipas legjislacionit të Kosovës dhe krahasimin e tij me sisteme tjera juridike.

Kapitulli i pestë përmban rregullimin ligjor të të drejtave fqinjësore në Kosovë, duke shqyrtuar në hollësi ngatërrimin e kufirit bazuar në ligj dhe vepra të autorëve të ndryshëm, shënimin dhe instalimet e kufirit, rregullimin e çëshjtes së pemës në kufi, imisionet, duke shpjeguar limiet dhe rregullimin e tyre, frutat, degët dhe rrënjët jashtë kufirit të pronarit të pronësisë dhe çëshje tjera të ndërlidhura, hyrjen e domosdoshme për marrjen e kafshëve, kalimin e domosdoshëm, të drejtën e kalimit për ndërtesa, shfrytëzimin e përkohshëm të një paluajtshmërie fqinje, ndërtimin përtej vijës së kufirit, mihjen rrezikuese si p.sh.në rastet e ndërtimit dhe rrjedhën e ujit. Më tej, janë paraqitur edhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve fqinje të paluajtshmërive, ku vërehet se njëri ka të drejtën e shfrytëzimit të paluajtshmërisë fqinje për nevojat e veta dhe të sendit të vet, kurse tjetri ka për detyrë të durojë këtë shfrytëzim dhe me këtë rast pronarët e paluajtshmërive fqinjë janë të detyruar që t'i marrin parasysh të drejtat dhe interesat e fqinjëve të tyre dhe të drejtat e tyre t'i ushtrojnë ashtu që të mos cenohen apo dëmtohen të drejtat e fqinjëve të tyre.

Kapitulli i gjashtë aspektet krahasuese të kufizimit të pronësisë nga të drejtat fqinjësore, ku shtjellohet e Drejta Fqinjësore me theks tek të drejtat dhe detyrimet e pronarit, servituti i kalimit

të rregulluara në bazë të Kodit Civil të Shqipërisë dhe në fund të kapitullit edhe aspektet krahasuese.

Kapitulli i shtatë paraqet të drejtat fqinjësore sipas kodit civil gjerman, duke shpjeguar asetet e rrezikshme, shembjen e menjëhershme të ndërtesës, mihjen, mbingarkesën (pemët në kufi), rënien e frutave, ndërtimin përtej vijës së kufirit (detyrimin për të toleruar), emergjencat (të drejtën për kalim të domosdoshëm), përjashtimin e së drejtës së kalimit, shënimin e kufirit, ngatërrimin e kufirit, përdorimin e përbashkët të instalimeve kufitare, mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes dhe së fundi pemën në kufi, të gjitha këto duke u dhënë edhe në aspekt krahasues, të cilin e kërkon tema e punuar.

Në kapitullin e tetë dhe të fundit janë dhënë konkluzionet e punimit, duke sqaruar në mënyrë gjithëpërfshirëse këtë punim dhe pikat kryesore të tij, me të cilin janë dhënë përfundimet e analizës.